

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT
HALIT D. CANI

Adresa: L. 5 Maj, Pall. 34/1, ose Turkut (pranë ish- Gjykates), Shka. 1, Kat. 2, Zyra 9, Elbasan Cel. 0695105151

Nr. 12 – 19 Gj. Regjist.

Elbasan, më 10.05.2019

URDHER
VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

✓ Drejtuar: Qëndres Kombetare e Biznesit

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Për Dijeni: Shoqëria "ENET" sh.p.k me NIPT K 427232040.

Adresa: Lagja 5 Maji, Rruga "Kozma Naska", Elbasan.

Në Elbasan, sot më datë 10.05.2019, Unë Halit CANI përmbarues gjyqësor privat, me numër liçense 28, & (NIPT) L03411202U, me seli në Elbasan, pasi shqyrtova materialet e dosjes përmbarimore nr. 12 – 19 Gj. datë 02.04.2019, që u përket palëve:

- Subjekti Kreditor: Shoqëria "Vëllezërit Hysa" sh.p.k
- Subjekti Debitor: Shoqëria "ENET" sh.p.k me NIPT K 427232040
- Objekti: Kthim Lekësh (Faturë Tatimore Shitje)

KONSTATOVA:

Se më datë 01.04.2019, është depozituar në zyrën përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor privat z. Halit D. Cani, Elbasan, kërkesa e subjektit kreditor Shoqëria "Vëllezërit Hysa" sh.p.k, për vënien në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit Nr. 07 (276), datë 16.01.2019, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan, për ekzekutimin e titullit ekzekutiv (Faturë Tatimore Shitje) 1-Nr. Fature 32 nr.serie 10572332, date 21.10.2014, të lëshuar nga subjekti kreditor Shoqëria "Vëllezërit Hysa" sh.p.k.

Në kushtet kur kane kaluar afatet e parashikuara nga neni 517 K. Pr. Civile, është vendosur fillimi i ekzekutimit të detyrueshem të titullit ekzekutiv (519 i këtij kodi), duhet të kryhet bllokimi mbi aksionet, kuotat e ortakeve, asetet, etj, në emër të subjektit debitor Shoqëria "ENET" sh.p.k me NIPT K 427232040, deri në një urdhër të dytë nga kjo zyre përmbarimore.

Sa siper ne baze e zbatim te neneve 527, 560, 563 e ne vijues te K. Pr. Civile, dhe nenit 31, germa”b”, 46/1, te ligjit nr.10 031, date 11.12.2008 (i ndryshuar)“Per Sherbimin Permbarimor Gjyqesor Privat”.

URDHEROJME:

- Vendosjen e mases se sekuestros konservative mbi aksionet, kuotat e ortakeve, asetet, etj që zotëron subjekti debitor **Shoqëria “ENET”sh.p.k me NIPT K 427232040.**

- Per veprimet apo mosveprimet tuaja na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor.


- Personat qe behen pengese, do te pergjigjen ne baze te nenit 606/2, te K. Pr. Civile, e nenit 320, Kodit penal.

- Bashkangjitur kopje të urdhërit të ekzekutimit Nr. 07 (276), datë 16.01.2019, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan , si dhe titullin ekzekutiv (Faturë Tatimore Shitje) 1-Nr. Fature 32 nr.serie 10572332, date 21.10.2014, të lëshuar nga Shoqeria “Vëllezërit Hysa” sh.p.k.

PERMBARUES GJYQESOR

Halit CANI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
ELBASAN

Nr.07(38) Regj.Them.
Dt.07.01.2019 Regj.

Nr.07(276) Vendimi
Dt.16.01.2019 Vendimi

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e përbërë nga:

GJYQTARE: MATILDA FETAU

Në Elbasan, sot më datë **16.01.2019**, asistuar nga sekretare gjyqësore Klodiana Ullorja, shqyrtoi në dhome këshillimi çështjen civile me **nr.07(38) regj.them.** që përket:

KËRKUES: **Vellezrit Hysa’ sh.p.k**, me NIPT K12911201C, me përfaqësues ligjor z.Besnik Hysa, me seli ne fshati Banjë e Re, Njësia Administrative Klos, Elbasan. Adresë: Pallati 15 katësh, pranë bashkise Elbasan. Tel 0694095881, email:zyrajuridike@vellezrithysa.al, gjenokristo@yahoo.com.

OBJEKTI: Lëshim i urdhërit të ekzekutimit për detyrimet monetare sipas faturave tatimore të shitjes më këto të dhëna: Fatura me tvsh nr.32 date 21.10.2014, nr.serial 10572332, me vlerë totale 110,424 lekë.

BAZA LIGJORE: Neni 510/e, neni 511 i Kodit të Procedures Civile, Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrime kontraktore e tregtare”.

Gjykata pasi shqyrtoi provat dhe çështjen në tërësi:

VËREN SE:

I. Faktet e çështjes.

1. Kërkuesi, shoqëria “Vellezrit Hysa” sh.p.k është një person juridik, i organizuar në formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me seli në fshatin Banje e Re, Klos, Elbasan, që ndër të tjera, ka për objekt të veprimtarisë së saj edhe realizimin e ndertimeve civile dhe industriale (*bazuar në ekstraktin elektronik të QKB-së, pjesë e dosjes gjyqësore*).

2. Në kuadër të kësaj veprimtarie, shoqëria "Vellezrit Hysa" sh.p.k ka kryer punimesh për shoqërinë "Enet" sh.p.k dhe për këtë qëllim është lëshuar fatura tatimore me me tvsh nr.32 date 21.10.2014, nr.serial 10572332, me vlerë totale 110,424 lekë. Fatura tatimore shoqërohet edhe me situacionin e punimeve, të nënshkruara respektivisht nga shoqëria "Vellezrit Hysa" sh.p.k dhe nga shoqëria "Enet" sh.p.k

3. Persa me siper, kërkuesi "Vellezrit Hysa" sh.p.k per punimet që ka kryer ka kërkuar lëshimin e urdherit të ekzekutimit për faturën tatimore të shitjes me me tvsh nr.32 date 21.10.2014, nr.serial 10572332, me vlerë totale 110,424 lekë. Nga shqyrtimi nga ana formale i kesaj faturave tatimore rezulton se, ajo është e rregullt dhe është nënshkruar si nga shoqëria "Vellezrit Hysa" sh.p.k ashtu edhe nga "Enet" sh.p.k. Në këtë mënyrë, duke nënshkruar faturen tatimore, objekt gjykimi, debitori shoqëria "Enet" sh.p.k e ka pranuar detyrimin që kjo faturë përmban.

II. Vlerësimi i Gjykatës.

4. Në lidhje me kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturat tatimore, objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se:

4.1. *Së pari*, urdhri i ekzekutimit për titujt ekzekutivë të parashikuar në nenin 510 të K.Pr.Civile është një vendim që merret nga gjykata kompetente, siç përcaktohet në nenin 511 të K.Pr.Civile. "*Kompetenca është një kusht procedural i vlefshmërisë së procesit gjyqësor dhe i akteve të realizuara gjatë tij në kuptimin që "Një gjykatë jo kompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale"*. Bazuar në nenet 36§1 dhe 41 të K.Pr.Civile, gjykata kryesisht konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

4.2. *Së dyti*, neni 510 i K.Pr.Civile përcakton se: "*Janë tituj ekzekutivë:..e)aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre"*. Nga interpretimi i këtij neni konkludojmë se është titull ekzekutiv akti që plotëson dy kushte: 1) parashikohet si titull ekzekutiv nga një ligj i posaçëm dhe 2) ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tij. Në këtë kuadër, neni 16 i ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" përcakton se: "*Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor...*". Kështu, fatura tatimore e shitjes, objekt gjykimi, përmban një detyrim monetar që rezulton se nuk është shlyer nga debitori "Enet" sh.p.k.

4.3. *Së treti*, detyrimi monetar që përmban fatura tatimore e shitjes, objekt gjykimi, është një detyrim i njohur, i përcaktuar saktë dhe është bërë i kërkueshëm. Ky detyrim ka lindur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.48/2014 dhe është pranuar nga "Enet" sh.p.k, përderisa administratori i saj ka nënshkruar faturën tatimore objekt gjykimi.

5. *Së katërti*, që të lëshohet urdhri i ekzekutimit, kërkesa duhet të bëhet nga titullari aktiv i titullit ekzekutiv, kreditori. Gjykata konstaton se ky kusht përmbushet plotësisht, pasi kërkuesi, shoqëria "Vellezrit Hysa" sh.p.k është kreditor i të gjithë detyrimit, që përmban fatura tatimore e shitjes, për të cilin kërkon të krijohet marrëdhënia juridike e ekzekutimit të detyrueshëm.

6. **Si përfundim**, në bazë dhe për zbatim të nenit 510/e dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 16 të ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" datë 24.04.2014, Gjykata çmon se kërkesa e shoqërisë "Vellezrit Hysa" sh.p.k për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet.


Sa më sipër u tha, gjykata në bazë të nenit 126, 309, 510/e dhe 511/ç të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI:


1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për titullin ekzekutiv: "**Faturë Tatimore Shitje**" me nr.32, nr.serial 10572332 date 21.10.2014, te lëshuar nga shoqëria "Vellezrit Hysa" sh.p.k, me NUIS K12911201C, perkundrejt shoqërisë "Enet" sh.p.k, me NUIS K427232040, për një detyrim në shumën 110,424 (njëqind e dhjetë mijë e katërqind e njëzet e katër) lekë.
3. Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje.
4. Urdhërohet shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, për ekzekutimin e këtij vendimi.
5. Shpenzimet gjyqësore nuk ka.
6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

U shpall sot në Elbasan, më datë 16.01.2019.

Sekretare
Klodiana Ullorja



**GJYQTARE
MATILDA FETAU**



FATURË TATIMORE SHITJE

Nr. i Serisë **10572332**

Data **21.10.2014**

EMRI I SHITËSIT: **Vollëza e Hyës shk**

Nr. i Faturës: **32**

ADRESA: **Elbasan**

TELEFONI: _____

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT)

K12A11201C

EMRI I BLERËSIT: **Evet shk**

ADRESA: **Elbasan**

TELEFONI: _____

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT)

K427232040


EMRI I TRANSPORTUESIT: _____

ADRESA: _____

TARGA E MJETIT: _____

ORA E FURNIZIMIT: _____

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT)

Nr	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Vlefte pa TVSH	Vlefte e TVSH	Vlefte me TVSH
1	2	3	4	5	6=4x5	7=6x20%	8=6+7
1-	<i>Punime me situacion te bregdetit J. D. L.</i>				92020	18404	110424
							

TOTALI

92020 18404 110424

Nga të cilat: Furnizime të tatueshme

Furnizime të patatueshme

- a) faqe 1: Originali - Blerësi
- b) faqe 2: Transportuesi
- c) faqe 3: Shitësi

BLERËSI
(emër, mbiemër, nënshkrimi)


[Signature]

TRANSPORTUESI
(emër, mbiemër, nënshkrimi)

SHITËSI
(emër, mbiemër, nënshkrimi, vulë)

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE E NOTERISË DURRËS
NOTERE NURIE GJORGA ELBASAN
NR. 49 REP.
Nr.tel.cel.0682160110



V È R T E T I M
I N J È S I S È M E O R I G J I N A L I N

Në bazë të nenit 129 dhe 62 gërma “i” ligji 110 dt.20.12.2018 Për Noterinë”

Sot në Elbasan më dt.02.04.2019 (dy prill dymijë e nëntëmbëdhjetë) ditën e martë, ora 12.00, para meje noteres Nurie V.Gjorga anëtare e Degës Vendore e Noterisë Durrës, me adresë ne lagjen “5Maj” Elbasan u paraqitën personalisht :

Shoqëria “VELLEZERIT HYSA” shpk e perfaqesur nga Besnik HYSA i biri i Ali me dtl.08.04.1973 lindur në Kamunah Elbasan dhe banues në Kamunah Elbasan, me nr. Personal H30408015R

I cili më paraqiti dokumentin për ta njësuar me origjinalin për “Faturë Tatimore Shitje nr 32 date 21.10.2014 me nr serial 10572332” për shoqërinë “VELLEZERIT HYSA” shpk

Unë noteria pasi verifikova origjinalin dhe fotokopjen dhe ato nuk kanë korigjime, dhe ndryshime vërtetova njësinë me origjinalin.

Kërkuessit ju bë e qartë përgjegjësia ligjore në rast paraqitje të një dokumenti të fallsifikuar, apo dhe në rast ndryshimi pas noterizimit të tij.

Unë noteria pasi verifikova dhe krahasova orgjinalin me fotokopjen, vërtetoj sipas ligjit se njësia është kopje e njejtë me dokumentin origjinal.

Taksa në zbatim të ligjit nr.110 dt.20.12.2018 për noterinë dhe urdhrin nr.279 dt.14.06.2012 i Ministrisë së Drejtesisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave „Për miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale“
Në këtë akt u aplikua taksa e pullës prej 200 lekë.



NOTERE
Nurie V.GJORGA